



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 705 Prot.

Tiranë, më 27.10 2015

**VENDIM Nr. 107, datë 21.10.2015**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "**Për Trashëgiminë Kulturore**" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.13, të datës 21.10.2015, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor, në kuadër të projektit "**HEC-ET në lumin e Osumit, në Qarr&Kaltanj**", **Qarku Korçë, Subjekti "Hidrocentrali Qarr&Kaltanj"sh.p.k.** realizuar nga nga individ i licencuar në arkeologji znj. Lida Miraj,

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor, në kuadër të projektit "**HEC-ET në lumin e Osumit, në Qarr&Kaltanj**", **Qarku Korçë, Subjekti "Hidrocentrali Qarr&Kaltanj"sh.p.k.** realizuar nga nga individ i licencuar në arkeologji znj. Lida Miraj, i cili duhet të ridepozitohet pranë ASHA, i plotësuar, pas korigjimit të vërejtjeve përkatëse, konform standarteve të kryerjes dhe paraqitjes së Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik, sipas vendimit të KKA Nr. 87 datë 15.07.2015.
- II. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrja e vazhdueshme arkeologjike nga DRKK Korçë, e cila duhet të depozitohet pranë Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dokumentacionin për të, duke lidhur më parë aktmarrëveshje tre palëshe me ASHA dhe investitorin, sipas vendimit të KKA Nr. 102, datë 1.09.2015.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [www.asha.gov.al](http://www.asha.gov.al)